

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8438, DATË 28.12.1998, “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar”, propozohet në kuadër të paketës fiskale 2019.

Ky projektligj synon:

- lehtësimin e ngarkesës fiskale mbi dividendin në përputhje me programin e Këshillit të Ministrave;
- lehtësimin e ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke zgjeruar fashën e të punësuarve që tatohen me shkallën 13%;
- mbrojtjen e bazës tatimore në Shqipëri, duke zgjeruar dhe qartësuar konceptin mbi burimet e të ardhurave në Republikën e Shqipërisë;
- sanksionimin në ligjin e brendshëm tatimor të së drejtës së vendit tonë për të tatuar në Shqipëri të ardhurat e realizuara nga shitja e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e aseteve/të drejtave që derivojnë nga pasuri të paluajtshme të vendosura në territorin e Republikës së Shqipërisë.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Lehtësimi i ngarkesës fiskale është një ndër objektivat dhe synimet e Këshillit të Ministrave të paraqitura edhe në programin e tij për periudhën 2017-2021. Në kuadër të stabilitetit makroekonomik, faktorë të rëndësishëm që kanë rol

thelbësor në këtë drejtim janë rritja ekonomike dhe përkrahja e sipërmarrjes jo vetëm me lehtësi procedurale, por edhe me politika fiskale të favorshme.

Ky lehtësim synon të targetojë jo vetëm individët, por edhe investitorët e kapitalit, dhe është në përputhje dhe harmoni dhe me reduktimet graduale të ngarkesës fiskale që janë miratuar në dy-tre vitet e fundit për bizneset e vogla dhe të mesme, si dhe për sektorë dhe industri të caktuara, të cilat ndikojnë dhe impaktojnë zhvillimin ekonomik të vendit sikurse janë turizmi, bujqësia, energjetika, inovacioni etj.

1. Reduktimi i normës së dividendit nga 15 % në 8 %, prezantohet si një masë e cila do ulë ngarkesën fiskale të investitorëve, duke nxitur alokimin më të shpejtë të kapitalit në ekonomi apo shtimin e konsumit.

Krahas nevojës për riinvestime dhe rritje kapitali nga ana e shoqërive, është e rëndësishme edhe lëvizja efikase e kapitalit financiar dhe nxitja e diversifikimit të portofoleve nga investitorët. Aktualisht norma e tatimit mbi dividendin prej 15 %, duke u kombinuar me normën e tatimit mbi fitimin korporativ 15 %, prodhon një ngarkesë fiskale prej 27.75 % për investitorët. Ndryshimi i propozuar ul ngarkesën fiskale për investitorët në 21.8%, nivel ky i krahasueshëm me tatimin efektiv të pagave të larta.

Krahas propozimit për aplikimin e tatimit të dividendit në shkallën 8 % , gjithashtu është propozuar që po kjo normë të aplikohet edhe për shpërndarjen e dividendëve që mund të bëjë shoqëria për fitimet e viteve para se ky ndryshim të prodhojë efekte (fitime të viteve 2018 e më parë), nëse tatimi mbi dividendin do të paguhet në afatet e përcaktuara. Kjo, pasi Ministria e Financave dhe Ekonomisë gjykon se një incentivë e tillë do të ndikojë pozitivisht si në të ardhurat e buxhetit të shtetit, ashtu edhe në rritjen e konsumit apo diversifikimit të kapitalit financiar në kompani të ndryshme.

2. Propozohet gjithashtu, ulje e ngarkesës fiskale për të punësuarit, duke e rritur fashën e të ardhurave, nga 130 000 lekë/muaj në 150 000 lekë/muaj, që taten me normën 13 %. Njëpërmjet kësaj mase synohet të ulet barra tatimore për rreth 15 400 punëmarrës.
3. Ruajtja dhe zgjerimi i bazës së tatimit në Shqipëri përbën një nga sfidat e rëndësishme për konsolidimin fiskal të vendit, pasi për të ardhurat që gjenerohen në Shqipëri, duhet që edhe tatimet të paguhen po në Shqipëri. Problemet e planifikimit agresiv tatimor, shmangies dhe minimizimit të tatimit, erozionit të bazës së tatueshme dhe zhvendosjes së fitimeve në parajsa fiskale apo juridiksione me nivele të ulta taksash, përbëjnë shqetësime serioze për administratat fiskale si të vendeve të zhvilluara ashtu edhe të vendeve në zhvillim. Në këtë kontekst, ndryshimet e propozuara synojnë që të ardhurat e realizuara nga shitja e drejtpërdrejtë apo e tërthortë e aseteve/të drejtave nga zotëruesit e tyre, pavarësisht kompleksitetit të

strukturës së pronësisë, dhe që janë të lidhura me asete /të drejta të vendosura në territorin e Republikës së Shqipërisë, duhet të tatohen në Shqipëri (ashtu sikundër tatohen ndryshimet e pronësisë të drejtpërdrejta brenda territorit të vendit).

4. Në përcaktimin e bazës së tatueshme për shoqëritë tregtare, rol të rëndësishëm luajnë shpenzimet e kryera nga ana e saj në kuadrin e veprimtarisë ekonomike. Referuar konstatimeve të administratës tatimore është vënë re rritje fiktive e shpenzimeve për dieta. Në këtë kuadër është e rëndësishme që për efekt të legjislacionit fiskal, të zbriten vetëm ato shpenzime, të cilat kryhen për qëllime të biznesit, që synojnë sigurimin dhe ruajtjen e të ardhurave. Pra, përfshirja në shpenzimet e panjohura të shpenzimeve të kryera nga shoqëritë për dieta stafi, të cilat tejkalojnë 50% të fondit të pagës bruto vjetore, është masë që ndihmon në ruajtjen e bazës së tatueshme dhe është në koherencë me parimet e ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji është mbështetur në nenet 78, 83, pika 1, dhe 155, të Kushtetutës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me *acquis* të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Neni 1 parashikon se do të konsiderohen të ardhura me burim në Republikën e Shqipërisë, të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat mbi pasurinë e paluajtshme që ndodhet në Republikën e Shqipërisë, nga të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerale, nga të drejtat për shfrytëzimin e pasurive hidrokarbure ose nga të drejta të tjera për shfrytëzimin e burimeve natyrore tokësore dhe ujore përfshirë detin në Republikën e Shqipërisë.

Pika 2 e këtij neni përcakton si të ardhura me burim në Republikën e Shqipërisë dhe të ardhurat nga tjetërsimi i pasurisë dhe të drejtave, si dhe nga tjetërsimi i aksioneve ose interesave të ngjashme, siç janë interesat në ortakëri ose truste kudo që ndodhen, në qoftë se, në çdo kohë gjatë 365 ditëve para tjetërsimit, këtyre aksioneve ose interesave të ngjashme ju buron më shumë se 50 për qind e

vlerës direkt ose indirekt nga pasuria e paluajtshme, të drejtat ose informacioni, në Shqipëri.

Gjithashtu, ky nen parashikon qartësimin e konceptit se të ardhurat e një personi joresident, të përfituara si rezultat i shërbimeve të kryera për një person rezident, do të konsiderohen të ardhura me burim në Republikën e Shqipërisë. Neni 2 përcakton se tatimi për të ardhurat nga dividendët për individët bëhet në shkallën 8 për qind.

Neni 3 përfshin në fushën e veprimit të tatimit mbi fitimin çdo person joresident që aktualisht nuk është pjesë e këtij neni, dhe që nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat. Ky parashikim ka për qëllim të sigurojë që joresidenti t'i nënshtrohet tatimit mbi fitimin nga shitja e aksioneve apo interesave të ngjashme, vlera e të cilave buron nga pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë.

Neni 4 përfshin në parashikimet për shpenzimet e panjohura dhe shpenzimet për dieta që tejkalojnë 50 për qind të fondit të pagës bruto vjetore, me qëllim ruajtjen e bazës së tatueshme.

Neni 5 parashikon se nëse gjatë një periudhe tatimore pronësia direkte dhe/ose indirekte e kapitalit aksionar, kuotave ose e të drejtave të votimit të një personi juridik ndryshon me më shumë se 20% në vlerë ose numër aksionesh/kuotash, personi juridik trajtohet si të jetë duke shitur një pjesë proporcionale të të gjitha pasurive të tij menjëherë përpara ndryshimit. Personi në këtë rast trajtohet si; a) përfitues i të ardhurave nga shitja, e barabartë kjo me pjesën proporcionale të vlerës së tregut të aktivitetit në atë kohë; dhe b) riblerës i aktivitetit për të njëjtën vlerë. Pika 2 i këtij neni parashikon se kur një person juridik paguan tatimin mbi fitimin sipas këtij ligji, bazuar në pikën 1, çdo ndryshim pronësie i aksioneve ose interesave të ngjashme që shkaktojnë ndryshimin është i përjashtuar nga tatimi mbi fitimin.

Pika 3 parashikon se personi juridik, i cili është subjekt i ndryshimit të pronësisë, duhet të njoftojë autoritetet tatimore me detajet e ndryshimit brenda 45 ditëve nga koha kur ka ndodhur ndryshimi.

Pika 4, për rastet për të cilat nuk zbatohet pika 3, parashikon detyrimin për njoftim që personi juridik ka ndaj administratës tatimore në rast të një ndryshimi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të pronësisë prej 10% ose më shumë dhe ky ndryshim pronësie është objekt i dispozitave të “burimit të të ardhurave”.

Neni 6 parashikon se një personi joresident, me qëllim pagesën e tatimit në Republikën e Shqipërisë i kërkohet të përgatisë një deklaratë të të ardhurave të tatueshme dhe deklarata duhet të dorëzohet sipas afateve të përcaktuara në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 7 parashikon mbajtjen e tatimit në burim në masën 8 për qind për pagesat e kryera për dividendë apo shpërndarje fitimesh.

Neni 8 përmban një shtesë në nenin 38 “Dispozita kalimtare”, duke sqaruar se norma e tatimit mbi dividendin në shkallën 8% do të aplikohet edhe për fitimet e pashpërndara të realizuara në vitet 2018 e më parë, përfshirë rezervat dhe fitimet e kapitalizuara, me kusht që tatimi mbi dividendin, që i përket fitimeve të pashpërndara të viteve 2017 e më parë, të paguhet brenda datës 30 shtator 2019, ndërsa tatimi mbi dividendin për fitimin e vitit 2018 të paguhet brenda datës 20 gusht 2019.

Neni 9 parashikon zëvendësimin e pasqyrës nr.1 me pasqyrën nr.1 që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij, me qëllim ndryshimin e tatimit për të ardhurat nga punësimi për kategorinë e punëmarrësve me të ardhura mbi 130 000 lekë në muaj.

Neni 10 parashikon botimin në “Fletoren zyrtare” dhe hyrjen në fuqi me datë 1 Janar 2019.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij projektligji.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Rritja e pagës që tatohet me 13% nga 130 000 në 150 000 lekë ka efekt buxhetor vjetor -319 milionë lekë.

Bazuar në arkëtimet e dividendit në vitet e kaluara, reduktimi i normës së tatimit mbi dividendët nga 15% në 8%, teorikisht ul të ardhurat nga ky tatim me rreth 1 miliard lekë në vit. Por pritshmëria është që të rritet numri, (i cili aktualisht është i ulët) i kompanive shpërndarëse si rezultat i pothuajse përgjysmimit të shkallës së tatimit. Pra, pritshmëria është që minimalisht të ardhurat në buxhet të tatimit mbi dividendin të mos reduktohen. Ndërkohë, incentiva që është propozuar për aplikimin e normës së reduktuar 8% edhe për shpërndarje të fitimeve të akumuluar nga vitet e kaluara, vlerësohet që të ketë impakt pozitiv në të ardhurat buxhetore të vitit 2019 me afërsisht 2 miliardë lekë.

KËSHILLI I MINISTRAVE